

## „Kompetent gjuhësor që nga fillimi“ – Fletat udhëzuese U8/U9 Këshilla për praktikimin e shumëgjuhësisë në familje

### Të dashur prindër,

Fëmija Juaj një kohë të gjatë e viziton kopshtin për fëmijë dhe ka pasur mundësi ta njohë/mësojë mirë gjuhën gjermane. Por ka të ngjarë që ai gjermanishten ta flasë dobët. Këshillat në vazhdim do t'ju ndihmojnë, që ta përkrahni fëmijën Tuaj në mësimin e mëtejshëm të gjuhës gjermane.

### Nëse fëmija Juaj është 4 vjeç, dhe gjermanishten e flet vetëm pak

- **Fëmija Juaj duhet të shkojë rregullisht (çdo ditë) në kopshtin për fëmijë dhe atje të krijojë miqësi me fëmijët që flasin gjermanisht.**

Fëmijës Juaj në kopshtin për fëmijë i ofrohen shanse të mëdha për ushtrimin/mësimin e gjuhës gjermane. Prandaj përkrahni fëmijën Tuaj bile edhe atëherë kur ai pasdite dëshiron të takohet me fëmijët që flasin gjermanisht ose të shkojë në ndonjë klub sportiv. Sidomos fëmijët që flasin gjermanisht janë shembuj shumë të mirë për mësimin e gjuhës gjermane.

- **Merrni pjesë në mbledhjet prindërore dhe në aktivitetet në kopshtin për fëmijë.**

Ky është në shans i mirë për t'u njoftuar me ndonjë familje gjermane, por edhe për të shkëmbyer (mendime, përvoja) me familjet e tjera që flasin gjermanisht.

- **Po qe se njohuritë e gjermanishtes i keni të pakta, Ju vetë patjetër duhet ta ndiqni një kurs të gjermanishtes. Atje do të keni mundësi që të mësoni gjuhën gjermane bashkë me fëmijën Tuaj.**

### Nëse fëmija Juaj është 5 vjeç, dhe gjermanishten e flet vetëm pak

Është afuar koha që fëmija Juaj të regjistrohët në shkollë. Është shumë me rëndësi që fëmija Juaj deri atëherë të mund të kuptojë dhe të flasë mirë gjermanisht. Nga njohuritë e tija të gjermanishtes do të varen në mënyrë vendimtare mundësitë e tija për mësim në shkollë.

- **Nëse fëmija Juaj deri më tani ka pasur vetëm pak kontakt me gjuhën gjermane, atëherë vetëm vizita në kopshtin për fëmijë nuk do të jetë e mjaftueshme.**

Fëmija Juaj duhet të marrë pjesë në mënyrë plotësuese në ndonjë kurs për përparimin e gjermanishtes.

- **Përkrahni fëmijën Tuaj në zhvillimin e pavarësisë së tij.**

Lëreni fëmijën Tuaj të kryejë blerje të vogla në mjedisin e zakonshëm (p.sh. të blejë një simite te bukëpjekësi), që të mund të ushtrojë të flasë gjermanisht.

### Nëse fëmija Juaj e ka vështirë ta mësojë gjuhën gjermane

Kjo është për shkak se fëmija deri më tani nuk ka pasur kontakte të mjaftueshme me gjuhën gjermane. Një nxitje specifike gjuhësore në kopshtin për fëmijë ose një kurs i gjermanishtes do të mund t'i ndihmonin fëmijës Tuaj që t'i përmirësojë kom-

petencat (aftësitë) e tija gjuhësore. Po qe se fëmijës Tuaj i shfaqen probleme edhe në gjuhën amtare, atëherë doemos duhet të konsultoheni me pediatrin Tuaj. Ai në rastin e dhënë do të iniciojë kontrolle të mëtejshme mjekësore për të vendosur se a bëhet fjalë për një shqetësim (defekt) gjuhësor. Kjo dukuri shfaqet pothuajse njësoj shpesh sikur te fëmijët që janë rritur me një gjuhë, po ashtu edhe te ata me më shumë gjuhë (rreth 6 – 10 % të fëmijëve parashkollorë). Shumëgjuhësia nuk është shkak për shqetësimet në zhvillimin gjuhësor. Në këtë rast përkrahja gjuhësore në kopshtin për fëmijë nuk është e mjaftueshme. Terapia gjuhësore ofron mbështetje optimale dhe kjo duhet të fillojë sa më shpejt.

### Pra, fëmija Juaj mund ta bëjë këtë

Ai tanimë në fjalitë komplekse flet me fjali kryesore dhe me fjali të varura dhe i zotëron të gjitha strukturat themeltare të gjuhës amtare.

### Kështu pra mund ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin e gjuhës

- **Shfrytëzoni rrethanat për biseda të përbashkëta me fëmijën Tuaj.**

Fëmijës Tuaj lexojini diçka në gjuhën amtare dhe në gjermanisht. Pastaj bisedoni me të për gjërat e lexuara dhe për ilustrimet (fotografitë). Parashtroni pyetje për historinë dhe sqarojani përbajtjet për të cilat pyet fëmija Juaj.

- **Të dëgjuarit e historive në CD dhe të kënduarit e përbashkët në të dy gjuhët shkakton gjithashtu shumë gëzim dhe kontribuon për përmirësimin e aftësive gjuhësore.**

- **Shfrytëzoni situatat me lojëra, si ndërtimet me elemente (module), kukulla ose ngjashëm, për të zhvilluar bashkërisht një bisedë.**

Flisni për gjërat të cilat Ju dhe fëmija Juaj i bëni përmes lojës ose merrni role të ndryshme të lojës. Për përkrahjen gjuhësore mund të shfrytëzohen edhe lojërat me rregulla të caktuara. Për shembull te lojërat që e zhvillojnë memorien (kujtesën) mund të përdorni fjali më të gjata si „Një hundëbri (rinoceront), ai jeton në Afrikë“ dhe „Një ari polar, ai jeton në Polin e Veriut“. Kjo nuk përshtatet.

- **Fëmija Juaj do të bëjë gabime edhe në gjuhën amtare, sidomos te format e vështira gramatikore ose te fjalët e ndërlikuara.**

Kjo është krejtësisht normale. Nëse Ju fjalinë e përsëritni edhe një herë në mënyrë korrekte dhe pa kërkuar qartë nga fëmija Juaj për ta përmirësuar, fëmija këto forma do të mund t'i mësojë më së miri.

**Fëmija:** „Në cirk i kemi ulur edhe karriget.“

**Prindi:** „Ah, Ju jeni ulur në karrige, dhe ç'ndodhi pastaj?“

- **Në bisedat me fëmijën Tuaj mos përdorni fjali të gjata, dhe atë që ia tregoni fëmijës Tuaj, zgjerojeni me informacione të reja.**

**Fëmija:** „Zjarrfikësi ka lëvizur/arritur shpejt.“

**Prindi:** „Saktë. Me siguri digjet një shtëpi dhe zjarrfikësi duhet ta fikë zjarrin sa më shpejt.“